



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:089315

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06299706

C.nr.576/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.P.me vendbanim në V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J.P., me vendbanim në V., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit (DKA në Vushtrri), të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ekrem Salihu, avokat me seli në Vushtrri me objekt kontesti anulim konkursi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 30.09.2024, kurse me datë 15.10.2024 mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R.P..
- II. ANULOHET KONKURSI nr. 99/21, i datës 02.02.2021, i shpallur nga e paditura DKA në Vushtrri, për pesë (5) pozita me titull “Eduktor/e për parashkollor, në shkollat fillore “Ali Kelmendi”-V., “Mustafë Venhari”-V., “Naim Frashëri”-V. “Mixheni”-S. dhe “Lumadhi”-L..
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja me datë 11.05.2021, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, me objekt kontesti anulim i konkursit nr. 99/21, i shpallur nga e paditura DKA në Vushtrri me datë 02.02.2021, kompensim dëmi jo material dhe kompensim i pagave të papaguara, kurse pas kthimit në plotësim të padisë nga gjykata, me precizimin e kërkesëpadisë, të datës 19.07.2024 paditësja ka paraqitur kërkesëpadi alternative me kërkesë primare anulimin e konkursit nr. 99/21,

ndërsa në rast të mos aprovimit të kësaj kërkesë, si kërkesëpadi alternative ka kërkuar nga e paditura kompensim dëmi për shkak të diskriminimit.

### *Pretendimet e palëve*

Paditësja me padi, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e saj në tërësi si e bazuar dhe të anulohet konkursi i të paditurës nr. 99/21, i datës 02.02.2021, me arsyetimin se e paditura e ka diskriminuar atë duke i'a pamundësuar pjesëmarrjen në procesin e rekrutimit të këtij konkursi vetëm për faktin se ajo ka diplomuar në një institucion privat të arsimit dhe për këtë arsye nuk ishte përfshirë në listën fillestare e të paditurës, me të cilën listë ishin përcaktuar emrat e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet formale të konkursit dhe ata të cilët sipas të paditurës nuk i kanë plotësuar kriteret. Ka shtuar se për shkak të mos përfshirjes në këtë listë, ka ushtruar ankesë por e paditura e ka refuzuar ankesën duke u referuar në nenin 16 par 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë, se për ta ushtruar detyrën e mësimdhënësit duhet që të diplomuarit të jenë vetëm nga bartësit publik të arsimit, mirëpo sipas saj ky arsyetim është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ (UA) 02/2017, për vlefshmërinë e programeve studimore të bartësve privat të arsimit të lartë dhe UA-në nr. 10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Ka shtuar po ashtu se e paditura, pas këtij konkursi, në konkurse të tjera, duke specifikuar konkursin nr. 900/23, ia ka mundësuar edhe kandidatëve të institucioneve private t'i nënshtrohen proceseve rekrutuese për mësimdhënës, duke përfshirë kandidatët A. Q., A. M., A. H., B. M., E. Z. M. , S. M., M. A. R. Z., V. H., Z. B., të cilët në konkursin kontestues njëjtë si edhe paditësen, i kishin përjashtuar nga lista fillestare me arsyetimin e njëjtë. Me parashtresën e datës 19.07.2024, paditësja ka paraqitur kërkesëpadi alternative, ashtu që ka kërkuar që në rast se nuk anulohet konkursi kontestues, asaj t'i kompensohet dëmi jo material për shkak të diskriminimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar me padi por nuk i ka specifikuar.

E paditura, me përgjigje në padi, gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadijinë e paditëses, duke kërkuar që gjykata ta refuzoj në tërësi. Ka shtuar se konkursi numër 02 Nr..99/21, i datës 02.02.2021 për pozitën "Edukator/e për parashkollor" ka qenë në harmoni me nenin 3, të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe nenit 16 pikës së 5-të të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, kurse në kohën e aplikimit paditësja lidhur

me dëshminë për kualifikim shkollor ka bashkangjitur Diplomën me numër Nr.651/20 të datës 13.07.2020 të lëshuar nga Kolegji “AAB” në Prishtinë, më të cilën dëshmohet se e njëjta ka përfunduar studimet në programin “Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve” dhe ka marrë titullin Bachelor nga bartësi privat i arsimit e jo publik. Përfaqësuesi i të paditurës nuk e ka mohuar pretendimin e paditëses se kandidatët A. Q., A. M., A. H., B. M., E. Z. M. , S. M., M. A. R. Z., V. H., Z. B., të cilit për arsyen e njëjtë me paditësen ishin konsideruar se nuk i plotësojnë kriteret e konkursit kontestues, i ishte mundësuar të aplikonin në konkursin 900/23, mirëpo sipas tij kjo gjë ka ndodhur nga nxjerrja e UA-së 01/2022, për ndryshimin dhe plotësimin të UA-së nr. 05/2021, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, e tutje, sipas të cilit i është mundësuar edhe të diplomuarave në institucione private t’i nënshtrohen proceseve rekrutuese për edukator për parashkollor nga 3-6 vjeç.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

### *Provat*

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

Konkursi numër 99/2021 i datës 02.02.2021, Ankesa e datës 13.04.2021, Lista me titull “Plotësimi i kriterëve për pozitën: Edukatore për parashkollor në shkolla fillore” e datës 26.03.2021, Njoftimi mbi vendimin i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA), me numër 284/11 i datës 13.07.2011, Vendimi i AKA-së me numër 1848/2020, i datës 28.09.2020, Vendimi i AKA- së nr. 442/18D e datës 18.05.2018, Vendimi i MASHT –it, nr, 01B/182 i datës 11.07.2011, Vendimi i AKA –së, nr. 549/2014, i datës 04.07.2014, Vendimi i Zyrës së Personelit të DKA Vushtrri me numër 14760/2021, e datës 01.04.2021, për refuzimin e ankesës së paditëses, Vendimi i Komisionit të ankesave të DKA Vushtrri, me nr. 18281/2021 i datës 28.04.2021, për refuzimin e ankesës së paditëses, Vendimi i AKA nr. 463/2010 të datës 19.07.2010, Plan programi i kolegjit AAB i datës 12.04.2021, Certifikata e Akreditimit për Kolegjin “AAB – Riinvest” Dhjetor – 2010, Diploma e paditëses e datës 13.07.2020 e Kolegjit AAB, Lista e kandidatëve e datës 21.12.2022, me titull “njoftim për rezultatet përfundimtare”, Dosja e konkursit numër 900/2023 e DKA Vushtrri e dorëzuar në gjykatë më datë 17.09.2024 dhe Dosja e konkursit numër 99/2021 e DKA Vushtrri e dorëzuar në gjykatë më datë 17.09.2024.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, përgjigjes në padi si dhe provave të administruara, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, duke çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja kishte aplikuar në konkursin nr.99/21, i datës 20.01.2023 por që e paditura nuk e kishte përfshirë në listën e ngushtë fillestare me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret, po ashtu nuk ishte kontestuese se e paditura ia kishte refuzuar ankesën paditëses lidhur me këtë vendim.

Deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk ishte kontestuese as fakti se e paditura nga momenti kur ka hyrë në fuqi e UA-së 01/2022, për ndryshimin dhe plotësimin të UA-së nr. 05/2021, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i'a ka mundësuar edhe të diplomuarve në institucione private të konkurrojnë së bashku me të diplomuarit e institucioneve publike, në konkurset për pozitat “edukator për parashkollor nga 3-6 vjeç” (Për këtë arsye gjykata nuk do të lëshohet në detaje në elaborimin e provave/akteve që kanë të bëjnë me secilin nga aktet e dosjes së konkursit nr.99/21 dhe 900/2023 të siguruara nga DKA-Vushtrri).

Kontestuese në mes palëve ishte nëse vendimi i të paditurës për mos përfshirjen e paditëses në listën e lëshuar nga Njësia e personalit, me datë 26.03.2021, me titull “Plotësimi i kriterëve për pozitën “Edukatore për parashkollor në Shkollë Fillore”, ishte në harmoni me legjislacionin në fuqi të asaj kohe.

Nga Konkursi numër 99/2021 i datës 02.02.2021, është përcaktuar se ky konkurs shpallet duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-068, të Arsimit në Komuna të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 03/L-068 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, UA-në (MASHT) nr. 10/18 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit publik, kriteret e këtij konkursi për pesë (5) pozitat e shpallura për Edukatore për parashkollor, kanë qenë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë kryer Fakultetin e Edukimit-Programi Parashkollor, shkollën e lartë pedagogjike-Drejtimi Edukatore, Fakulteti Filozofik-Dega e Pedagogjisë së Përgjithshme ose Fakultetin e Shkencave Sociale-Programi Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve.

Nga lista e të paditurës, e lëshuara nga Njësia e personalit, me datë 26.03.2021, me titull “Plotësimi i kriterëve për pozitën “Edukatore për parashkollor në Shkollë Fillore”, janë evidentuar emrat e 105 kandidatëve, ashtu që paditësja është renditur me nr. 81 dhe është vlerësuar se nuk i plotëson kriteret e konkursit.

Nga Vendimi i Zyrës së Personelit të DKA V. me numër 14760/2021, e datës 01.04.2021, për refuzimin e ankesës së paditëses së datës 31.03.2021, është theksuar se ankesa e paditëses për mos përfshirje në listën e ngushtë është e pabazuar ngase me neni 16 par 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë, vetëm nga bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimitdhënësi për tu punësuar në një shkollë.

Nga Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të DKA-së, nr. 18281/21, i datës 28.04.2021, është refuzuar ankesa e paditëses e datës 13.04.2021 e paraqitur ndaj Vendimit të Zyrës së Personelit të DKA Vushtri me numër 14760/2021, me arsyetimin se sipas nenit 16 par 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë, vetëm nga bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimitdhënësi për tu punësuar në një shkollë.

Nga Vendimi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA), nr. 463/2010 të datës 19.07.2010, është vërtetuar se Kolegji “AAB-Riinvest”, ka ri akredituar për tri programe akademike, duke përfshirë edhe programin “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve” për periudhën 01.10.2010-30.09.2011 (1 vit).

Nga Njoftimi mbi vendimin i AKA –së me numër 284/11 i datës 13.07.2011, është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për tri programe akademike, duke përfshirë edhe programin “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve” për periudhën 01.10.2011-30.09.2014 (3 vite), kjo e përcaktuar edhe me vendimin e MASHT-it nr. 1567, të datës 11.07.2011.

Nga vendimi i AKA –së, nr. 549/2014, i datës 04.07.2014, është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për programin “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve” për periudhën 01.10.2014-30.09.2019 (5 vite).

Nga Vendimi i AKA- së nr. 442/18D e datës 18.05.2018 është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për disa programe akademike, duke përfshirë edhe programin “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve” për periudhën 01.10.2019-30.09.2020 (1 vit)

Nga Vendimi i AKA-së me numër 1848/2020, i datës 28.09.2020, është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për disa akademike, duke përfshirë edhe programin “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve” për periudhën 01.10.2020-30.09.2021 (1 vit).

Nga diploma e paditëses në Kolegjin “AAB”, me nr. 651/20, është vërtetuar se paditësja me datë 13.07.2020, ka diplomuar në programin e këtij Kolegji “Përkujdesje dhe mirëqenie e fëmijëve”.

Me nenin 16 par 5, të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës është përcaktuar që *“Vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t’u punësuar në një shkollë”*, kurse me nenin 1 të UA-së (MASHT) nr. 02/2017 për vlefshmërinë e programeve studimore të bartësve të arsimit të lartë, (Tani e tutje UA-02/2017) është përcaktuar që ky UA, nxirret me qëllim të përcaktimit të kriterëve për bartësit e arsimit privat të arsimit të lartë që shpie në sigurimin e vlefshmërisë së programeve studimore që kanë qenë të akredituara para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe trajtimin të barabartë të diplomave, gradave dhe kualifikimeve të tyre, me programet studimore të ofruara nga Institucionet Publike, e te cilat qojnë në kualifikimin për mësimdhënës.

Me nenin 2 të UA-së (MASHT) 10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm (Tani e tutje UA-10/2018), i cili UA, ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes (02.02.2021) dhe fazave të rekrutimit të konkursit kontestues, ka qenë e paraparë që *“Institucionet edukative dhe arsimore gjatë publikimit të konkurseve për vendet e lira të punës kërkojnë kuadro sipas këtij UA”*, kurse me nenin 3 par 2.4 ka qenë e paraparë që njëri nga kuadrot e kërkuar për edukimin parashkollor është Fakulteti i Shkencave Sociale-programi “Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve”.

Sipas nenit 1, të UA-së (MASHT) nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i cili ka hyrë në fuqi më 26.06.2021 (pra pas procesit rekrutues të konkursit kontestues) është përcaktuar që *“Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i normativit për kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, në edukimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët, arsimin e mesëm të lartë dhe konviktet e nxënësve”*, kurse me nenin 2 të tij është paraparë që kriteret për kuadrin profesional për mësimdhënësit e kopshteve të fëmijëve nga 3-6 vjet, të jenë *“2.1, Fakulteti i*

*Edukimit-programi katërvjeçar i nivelit baçelor për edukimin parashkollor; 2.2, Shkolla e lartë pedagogjike-drejtimi për edukatorë, 2.3, Fakulteti Filozofik-dega e pedagogjisë së përgjithshme” ndërsa me nenin 3, të UA-së nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e UA-së 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, është paraparë që nenit 12 të UA-së (05/2021), i shtohet paragrafi 6, me këtë përmbajtje “Të gjithë kandidatët e kualifikuar në programin “përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve”, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, i plotësojnë kriteret për punësim në kopsht 3-6 vjeçar”.*

Gjykata ka vendosur si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi ashtu që ka anuluar konkursin nr. 99/21, të datës 02.02.2021, për arsye se gjatë shqyrtimit kryesor është provuar se procedura rekrutuese për përzgjedhjen e kandidatëve fitues të këtij konkursi nuk është zhvilluar sipas kriterëve ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën këtij procesi rekrutues dhe atë për arsyet si më poshtë:

E paditura, konkretisht Njësia e Personalit e të paditurës, nuk e kishte përfshirë paditësen në listën me titull “Plotësimi i kriterëve për pozitën: Edukatore për Parashkollor në Shkolla Fillore”, ashtu që në arsyetimin me nr. 81 ku ishte e renditur paditësja, ishte evidentuar se ajo nuk i plotëson kriteret e konkursit, pa u specifikuar ndonjë arsyetim se cilin kriter nuk e plotëson, mirëpo nga Vendimi i Zyrës së Personelit të DKA Vushtrri me numër 14760/2021, i datës 01.04.2021, për refuzimin e ankesës së paditëses së datës 31.03.2021 dhe nga Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të DKA-së, nr. 18281/21, i datës 28.04.2021, të së paditurës ishte theksuar se paditësja nuk është përfshirë në listën e ngushtë sepse me nenin 16 par 5, të Ligjit për Arsimin e Lartë, vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për tu punësuar në një shkollë.

Ky pretendim i të paditurës, i theksuar edhe në përgjigje në padi dhe gjatë seancave për mos përfshirjen e paditëses në listën fillestare për këtë proces rekrutues, është tërësisht i pabazuar. Kjo ngase, pavarësisht se me nenin 16 par 5, të [Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës](#), është përcaktuar që “Vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t’u punësuar në një shkollë”, po me këtë ligj, me nenin 2 par 1.2 dhe 1.3 është përcaktuar që “Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet si në vijim: 1.2 barazia para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë, 1.3. mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim”. Duke u bazuar në këto parime për trajtim të

barabartë për të gjithë studentet e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-i, si organ kompetent për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji (Neni 35), me datë 16.02.2017, ka nxjerrë [UA-në 02/2017](#) që ka përcaktuar kriteret që duhet t'i plotësojnë bartësit e arsimit privat të arsimit të lartë që kanë qenë të akredituara para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të diplomuarit e programeve të tyre të cilat qojnë në kualifikimin për mësimdhënës, të kenë trajtim të barabartë me të diplomuarit e institucioneve publike.

Me nenin, 2 par 1.4 dhe 1.5.1 të UA-së 02/2017, parashihet që *“Bartësve privat të arsimit të lartë, që iu sigurohet vlefshmëria e programeve studimore të cilat qojnë në kualifikimin për mësimdhënës, programe që kanë qenë të akreditura dhe licencuara para hyrjes në fuqi të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037 datë 9 shtator 2011 janë: 1.4 Bartësit privat të arsimit të lartë dhe programet e tyre të akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, vendimi mbi akreditimin e të cilave ka përmbajtur edhe programet e edukimit për fusha përkatëse, 1.5.1 Programet studimore të BprAL, që të drejtën e organizimit të mësimin në këto programe e kanë fituar para hyrjes në fuqi Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037 dhe të cilave i është vazhduar ri akreditimi dhe ri licencimi vazhdojnë të konsiderohen të barabarta me programet e njëjta të ofruara nga Institucionet Publike përgjatë periudhës sa zgjatë (ri) licencimi dhe (ri) akreditimi i tyre”.*

Ndërsa me nenin 3 të UA-s 02/2017 (Trajtimi i barabartë ligjor), është paraparë që *“Të gjithë të diplomuarit në programet studimore që kanë qenë të (ri) licencuara dhe (ri) akredituara sipas nenit 2 të këtij Udhëzimi Administrativ, konsiderohen të barabartë me të diplomuarit në Institucione Publike”.*

Në anën tjetër, nga Vendimi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA), nr. 463/2010 të datës 19.07.2010, është vërtetuar se Kolegji “AAB-Riinvest”, është ri akredituar për tri programe akademike, duke përfshirë edhe programin *“Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve”* për periudhën 01.10.2010-30.09.2011 (1 vit), po ashtu nga njoftimi i AKA –së me numër 284/11 i datës 13.07.2011, është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për tri programe akademike, duke përfshirë edhe programin *“Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve”* për periudhën 01.10.2011-30.09.2014 (3 vite), kjo e përcaktuar edhe me vendimin e MASHT-it nr. 1567, të datës 11.07.2011, edhe nga vendimi i AKA –së, nr. 549/2014, i datës 04.07.2014, është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për programin *“Përkujdesja dhe mirëqenia e*



*fëmijëve*” për periudhën 01.10.2014-30.09.2019 (5 vite) si dhe nga Vendimi i AKA- së nr. 442/18D e datës 18.05.2018 është vërtetuar se Kolegji “AAB”, është ri akredituar për disa programe akademike, duke përfshirë edhe programin “*Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve*” për periudhën 01.10.2019-30.09.2020 (1 vit).

Nga këto vendime të AKA-së, gjykata ka vërtetuar se para hyrjes në fuqi të Ligjit për Arsimin e Lartë (24.09.2011), Kolegji “AAB”, në të cilin institucion ka diplomuar paditësja, ka qenë i akredituar për programin “*Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve*”, të cilin program akademik [UA-së 10/18](#), që ka qenë në fuqi në kohën e konkursit kontestues e ka paraparë si kuadër për tu punësuar si edukatore për parashkollor. Përpos faktit se ky program i këtij Kolegji ka qenë i akredituar para hyrjes në fuqi të ligjit për arsimin e lart, ky program është ri akredituar në vazhdimësi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ashtu që sipas Vendimit të AKA- së nr. 442/18D e datës 18.05.2018 është vërtetuar se Kolegji “AAB”, e ka pasur të ri akredituar programin “*Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve*”, për periudhën 01.10.2019-30.09.2020, pra edhe në kohën kur paditësja me datë 13.07.2020 ka diplomuar në këtë program.

Prandaj, nga të lartcekurat gjykata ka vërtetuar se e paditura, duke e përjashtuar paditësen nga lista e ngushtë fillestare me arsytimin se nuk plotëson kriteret e konkursit, me pretendimin se vetëm institucionet publike ofrojnë programe studimi për kualifikimin e një mësimdhënësi, ka bërë shkelje të nenit 24 par 1, të Kushtetutës së Kosovës (Barazia para ligjit), sipas të cilit përcaktohet se “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*” dhe nenit 1 të Protokollit nr.12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo ngase pavarësisht se me UA-në 02/17, që ka qenë në fuqi në kohën e procesit rekrutues të konkursit, është përcaktuar se janë të barasvlershme diplomat e bartëseve të arsimit privat dhe atyre publik për programet për mësimdhënësi, me kusht që bartësi privat të jetë i akredituar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe t’i vazhdohet ri akreditimi dhe faktit se paditësja ka diplomuar në Kolegjin “AAB”, në programin “*Përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve*”, i cili program ka qenë i akredituar nga AKA-ja, para hyrjes në fuqi të Ligjit dhe është ri akredituar në vazhdimësi, e paditura në kundërshtim me këto dispozita, ka vendosur që paditësen mos ta përfshij në listën e ngushtë fillestare, me të cilën janë përcaktuar kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet formale për t’iu nënshtruar procedurave rekrutuese të konkursit dhe në këtë mënyrë i’a ka mohuar asaj që të jetë pjesë e fazave të mëtutjeshme të procesit rekrutues.

Gjatë këtij shqyrtimi e paditura ka theksuar se vetëm pas hyrjes në fuqi të UA-së nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e UA-së 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, ku me nenin 2 par 3 të tij është paraparë që nenit 12 të UA-së (05/2021), i shtohet paragrafi 6, me këtë përmbajtje “*Të gjithë kandidatët e kualifikuar në programin “përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve”, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, i plotësojnë kriteret për punësim në kopsht 3-6 vjeçar*”, i’ a ka mundësuar përfshirjen në proceset rekrutuese edhe kandidatëve të diplomuar në institucione private, me arsyetimin se vetëm atëherë i është lejuar të diplomuarve të këtij drejtimi të punësohen si mësimdhënës, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është tërësisht i pabazuar ngase me këtë dispozitë të UA-së nr. 01/2022, vetëm është shtuar e drejta për punësim në kopshtin për moshën 3-6 vjeç edhe për të kualifikuarit në programin “*përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve*”, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, pra ky UA nuk ka rregulluar çështjen e barasvlefshmerinë e diplomave të institucioneve publike dhe atyre private por ka për objekt vetëm kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Lidhur me këtë duhet theksuar po ashtu se ashtu siç përcaktohet me nenin 2.3 të UA-së nr. 01/2022, në të cilin është referuar e paditura, edhe me nenin 3 par 2.4 të [UA-së 10/2018](#), o cili ka qenë në fuqi në kohën e shpalljes (02.02.2021) së konkursit kontestues, programi “*përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve*”, ka qenë i paraparë si njëri nga kuadrot e kërkuar për edukimin parashkollor, për pozitat për të cilat është shpallur edhe konkursi kontestues. Prandaj argumenti i të paditurës se kandidatet e këtij programi nga institucionet private të arsimit kanë mund të punësohen si mësimdhënës tek e paditura vetëm pas hyrjes në fuqi të UA-së nr. 01/2022, është i pabazuar sepse rregullimi ligjor për kuadrin profesional për edukimin parashkollor për fëmijët 3-6 vjeç ka qenë i ngjashëm edhe me UA-në 10/2018. Mirëpo ashtu siç u sqarua më lartë, e paditura mos përfshirjen e paditëses nga lista fillestare e kandidatëve nuk e ka bërë për çështjen e kualifikimit të saj por me arsyetimin se vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që qojnë në kualifikimin e një mësimdhënësi për t’u punësuar në një shkollë, i cili pretendim është në kundërshtim me nenin 3 të UA-së nr. 02/17, me të cilin të diplomuarit e bartësve privat siç është rasti me Kolegjin “AAB”, për programin në të cilin paditësja ka diplomuar, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë me të diplomuarit e institucioneve publike lidhur me vlefshmerinë e diplomave të tyre në programet të cilat qojnë në kualifikimin si mësimdhënës.

Pasi paditësja ka paraqitur kërkesëpadi alternative, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të kompensohet për dëmin jo material vetëm në rast se nuk anulohet konkursi kontesues si kërkesë parësore e saj, gjykata për faktin se e ka aprovuar kërkesëpadinë primare të paditëses, me këtë aktgjykim nuk e ka trajtuar fare kërkesën për kompensim dëmi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 450 dhe 463 par 1 të LPK-së, sipas të cilit përcaktohet që *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*, për faktin se paditësja deri në përfundim të shqyrtimit kryesor nuk i ka specifikuar se çfarë shpenzime procedurale ka pasur dhe cila është vlera e atyre shpenzimeve.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:089315, C.nr.576/2021, me datë 15.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.